KËRKESË
Nr.1481/2, datë 14.4.2010

PËR SHPRONËSIM ME INTERES PUBLIK

Në mbështetje të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik", Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor "Unaza Fushë-Arrës".

Subjekti kërkues i këtij objekti është Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve. Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkojmë të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur nga Komisioni i Posaçëm i Shpronësimit pranë Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

Pronarët që kanë emrin në listën emërore dhe personat e tretë, brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre lidhur me çmimin, sipërfaqen, titullin e pronësisë apo llojin e pasurisë që kanë në pronësi, të shoqëruara me dokumentet përkatëse në ministrinë kompetente (Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit).

Sqarojmë që kjo shpallje kërkese për shpronësim bëhet vetëm për pasurinë e llojit "tokë truall dhe objekte".

Pasuritë me shënimin "Proces regjistrimi, plotësim dokumentacioni (objekti)" do të kompensohen pasi të kenë përfunduar regjistrimin e pasurisë në zyrën e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, si dhe të kenë paraqitur dokumentin hipotekor të pronës (brenda afateve të vlefshmërisë së tij). Pasuritë me shënimin "Konfirmim nga ZRPP" do të kompensohen pas daljes së vendimit të Këshillit të Ministrave, si dhe pasi të kenë dorëzuar dokumentin e pronësisë pranë DPRR-së.

Vlera totale e shpronësimit është 29 981 708 (njëzet e nëntë milionë e nëntëqind e tetëdhjetë e një mijë e shtatëqind e tetë) lekë.

MINISTRI I PUNËVE PUBLIKE,
TRANSPORTIT DHE TELEKOMUNIKACIONIT
Sokol Olldashi

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E PUNËVE PUBLIKE TRANSPORTIT DHE TELEKOMUNIKACIONIT
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E RRUGËVE
DREJTORIA E SHPONËSIMEVE

LISTA PARAPRAKE E PRONARËVE, PASURITË E TE CILËVE SHPRONËSOHEN SI REZULTAT I NDËRTIMIT TË SEGMENTIT RRUGOR "UNAZA FUSHË- ARRËZ"

Nr	EMRI, ATËSIA, MBIEMERI	Z.Kadast.	Nr.Pas.	TRUALL			OBJEKTE		Vlera totale (lekë)	SHËNIME
				Sip.m^2	Çmimi m^2	Vlera në lekë	Lloi i objektit	Vlera në lekë		
1	Fran Ndue Qafa	1656	14	36	642	23112	Bodrum	623382	**646494**	Proces regjistrimi,plotesim dokumentacioni (objekti)
2	Sejdi Mus Sadria	1656	53	48	642	30816	Lokal+Ambjente Sanitare	4900089	**4930905**	Proces regjistrimi,plotesim dokumentacioni (objekti)
3	Kol Pjetre Kola	1656	6	1002	642	643284	Ambjent ndertimi, perpunim druri	3982489	**4625773**	Proces regjistrimi,plotesim dokumentacioni (objekti)
4	Zef Lek Ndoci	1656	176	46	642	29532	Pike karburanti	4492852	**4522384**	Proces regjistrimi,plotesim dokumentacioni (objekti)
5	Zef Lek Ndoci	1656	1161	128	642	82176			**82176**	Konfirmim nga ZRPP
6	Viktor Ndue Qafa	1656	106	6	642	3852			**3852**	Konfirmim nga ZRPP
7	Ndrec Ndue Qafa	1656	5	210	642	134820			**134820**	Konfirmim nga ZRPP
8	Tonin Viktor Qafa	1656	130	55	642	35310	Karburant	5394666	**5429976**	Proces regjistrimi,plotesim dokumentacioni (objekti)
9	Marash Mehill Pepa	1656	1332				Gomisteri	1506408	**1506408**	Proces regjistrimi,plotesim dokumentacioni (objekti)
10	Marjana Mark Bala	1656	14				Bar Bufe	1889646	**1889646**	Proces regjistrimi,plotesim dokumentacioni (objekti)
11	Leonard Nik Leka	1656	1099/1				Kapanon	639941	**639941**	Proces regjistrimi,plotesim dokumentacioni (objekti)
12	Gjovalin Lek Ndoci	1656	84				Karburant	988347	**988347**	Proces regjistrimi,plotesim dokumentacioni (objekti)
13	Alfred Lek Ndoci	1656	1543				Bar -Bufe	2228712	**2228712**	Proces regjistrimi,plotesim dokumentacioni (objekti)
14	Zef Ndue Qafa	1656	1606				Stalle	1674274	**1674274**	Proces regjistrimi,plotesim dokumentacioni (objekti)
15	Pjeter Preng Bardhoku	1656	90				Gomisteri	678000	**678000**	Proces regjistrimi,plotesim dokumentacioni (objekti)
	SHUMA			**1531**		**982902**		**28998806**	**29981708**	**TOTALI**